



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4909/2 Prot.

Rreshën me, 09.12.2022

V E N D I M

Nr. 100 datë 30. 11. 2022

**PËR
"MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE VENDORE, PËR VITIN 2023"
BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenet 34, 54, shkronja "f", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit nr. 9632, dt. 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" (*i ndryshuar*); ligji 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" (*i ndryshuar*), ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", (*i ndryshuar*), ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor në RSH" (*i ndryshuar*), VKM nr. 132 datë 07.02.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa" e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", nenit 128, të ligjit nr. 8485, ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Udhëzimi nr. 32, datë 31.12.2013, të Ministrit të Financave "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"; ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 57/2020, "Për pyjet", Udhëzimi nr. 15, datë 24.07.2007, "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit Rrugor"; Udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, "Për përcaktimin e kriterëve rregullave dhe dokumntacionin për lëshimin e certifikatave për ushtrimin e veprimarisë në transportin rrugor të udhëtareve brenda vendit" (*i ndryshuar*), ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", (*i ndryshuar*), VKM nr. 607, datë 29.7.2020 "Për tarifatat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, pas dëgjësave publike në çdo njësi administrative të bashkisë Mirditë dhe shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, me paraqitjen e projekt-vendimit të kryetarit të Bashkisë Mirditë, pas shqyrtimit në mbledhjen e komisionit të ekonomisë, financës dhe buxhetit të këshillit bashkiak, për t'a kaluar në mbledhjen e këshillit bashkiak Mirditë, pas diskutimeve:



VENDOSI:

1. Të miratojë Paketën Fiskale Vendore, për vitin 2023, të bashkisë Mirditë si vijon:

I. TAKSAT VENDORE

Në zërin "taksa vendore", konform ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sitemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, përfshihen llojet si më poshtë:

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin e Biznesit të vogël.
2. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme.
3. Taksa e fjetjes në Hotel
4. Taksa e ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.
5. Taksa e Tabelës
6. Taksa të Përkohëshme
7. Taksat e ndara

1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL.

Çdo subjekt, person fizik apo juridik, i cili kryen një veprimtari ekonomike (biznes) me anën e të cilit realizohet qarkullim vjetor më i vogël ose i barabartë me 8 milion lekë i detyrohet pagesës së detyrimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit për biznesin e vogël.

Parapagimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin vijues, për tatimpaguesin me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzimin e Ministrisë të Financave.

Afatet e pagesës: Tatimpaguesi parapaguan në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën shqiptare apo të tjera institucione bankare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill për muajin janar, shkurt, mars dhe datës 20 korrik për muajt prill, maj, qershor, brenda datës 20 tetor për muajt korrik, gusht, shtator dhe brenda datës 20 dhjetor për muajt tetor, nëntor, dhjetor.

Shkalla tatimore: Tabela sqaruese e aplikimit të shkallës tatimore për kategoritë e taksapagesve.

| Nr. | Qarkullimi | Njësia | % |
|-----|--------------------------------------|----------|---------------|
| 1 | Me qarkullim vjetor nga 0-8 mln lekë | Lekë/vit | 0% |
| 2 | Me qarkullim vjetor 8-14 mln lekë | | 5 % e Fitimit |



Struktura përgjegjëse për vjeljen e tatimit: Drejtoria Rajonale Lezhë, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

2.TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme Ndërtesë

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa e truallit

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Detyrimet për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që janë të pajisur me dokumente pronësie.

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike. Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a. Taksa mbi ndërtesën
- b. Taksa mbi tokën bujqësore
- c. Taksa mbi truallin

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë Mirditë, e cila më pas ka të drejtë, që të ngrëjë një komision nga stafi i Drejtorisë taksave dhe tarifave vendore, i cili bën matjen faktike në terren të sipërfaqes përkatëse dhe më pas akt-konstatimi i kalon për vlerësim sektorit të vlerësimit në drejtorinë e taksave dhe tarifave vendore, konform ligjit 9632 “për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”

2/I Taksa mbi Ndërtesën

Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror e ndërtesës ose pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për cdo kat. Dokumentet, që vërtetojnë pronësinë janë Certifikata e pronësisë, Vendimi i komisionit të kthimit të pronave, Vendimi i Privatizimit etj, dokumentet konform legjislacionit në fuqi.



| Nr. | Katekoritë e ndërtesave | Njësia | Niveli i taksës |
|----------|--|--|--|
| A | Ndërtesa Banimi | Lekë/m ² sipërfaqe | |
| a | Njësia administrative Rreshën | | 21 lekë/m ² |
| b | Njësia administrative Rubik dhe të gjitha Njësitë e tjera administrative | | 14.75 lekë/m ² |
| B | Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë. | | Zona Rreshën 126 lekë/m ² Zona Rubikut 88.5 lekë/m ² |
| C | Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve. | | Zona Rreshën 58.8 lekë/m ² Zona Rubikut 41.4 lekë/m ² |
| D | Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve. | Zona Rreshën 25,2 lekë/m ² Zona Rubikut 17,7 lekë/m ² | |
| E | Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve. | Zona Rreshën 42 lekë/m ² Zona Rubikut 29,5 lekë/m ² | |



| | | | |
|----------|--|--|--|
| | | | |
| F | Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor. | | Zona Rreshën 25,2 lekë/m² Zona Rubikut 17,7 lekë/m² |
| G | Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23. 12. 1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë. | | Zona Rreshën 58,8 lekë/m² Zona Rubikut 41,3 lekë/m² |
| H | Për ndërtesa në proces ndërtimi, të cilat kanë tejkaluar afatin e lejes së ndërtimit | | 30% e zërit përkatës të taksës |

Detyrimi për pagesë të taksës: Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizik ose juridik, vendas ose të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen persona që kanë aplikuar për legalizimin e ndërtesës sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" si dhe zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit (në këtë rast afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi).

Detyrimi për taksën vendore mbi pasurinë e paluajtshme - ndërtesë është vjetor. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin



e Këshillit të Ministrave. Detyrimi i pagesës llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

Kategorizimi i Ndërtesave;

- a. Ndërtesa banimi konsiderohen ato ndërtesa të cilat përdoren nga qytetarët vetëm për qëllime banimi dhe jo për qëllime fitimprurëse si dhe ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.
- b. Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra, konsiderohen ato ndërtesa, të cilat shrytëzohen nga pronarët e tyre për qëllime fitimprurëse që ushtrojnë aktivitete private në fushën:
 - ✓ e tregëtisë, si tregtim artikuj industrialë ushqimor, fruta, perime etj, të ngjashme me to.
 - ✓ të shërbimeve, si agjensi bankare, këmbim valutor, doganore, hoteleri-turizëm, turizëm familjar, palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, qendra shitje karburanti, farmaci, klinika, spitale, agjensi sigurimesh, agjensi transporti, autoservise, autoshkolla, lavanteri, pastrim kimik, rojet civile, salla lojra të ndryshme, marangoz, riparime, parukeri/floktore, rrobaqepësi etj, të ngjashme me to.
 - ✓ profesione të lira, si avokat, noter, studio konsulente, ekonomist, inxhinier, mjek, fundacione të ndryshme, etj të ngjashme.
- c. Ndërtesa për prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale dhe ushqimore duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat, përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letra, kartoni, shtypshkronjë, tulla, tjegulla, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksione, prodhim dhe përpunim vajra, karburante, etj, prodhim dhe përpunim produkte farmaceutike dhe objektet e tjera të ngjashme me to.
- d. Ndërtesa për parkim:
 - ✓ *të mbyllur*, konsiderohen ato ndërtesa që përdoren për ushtrim aktiviteti si shërbim parkimi për të tretët, në ambiente të mbyllura ose nëntokësore.
 - ✓ *Të hapur* konsiderohen ato ndërtesa, që përdoren për ushtrimin e aktivitetit si shërbim parkimi për të tretët në ambiente të hapura.
- e. Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse si: grumbullim, magazinim, dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, konsiderohen ato ndërtesa si stalla për bagëti, magazinat e ruajtjes së produkteve bujqësore e blegtorale, bimëve medicinale, etj të ngjashme me to.

Shkalla e taksës: Shkalla e taksës mbi ndërtesat aplikohet si përqindje e bazës së taksës dhe është si më poshtë:

- 0.05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim.



- 0.2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
- 30 % e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Baza e taksueshme: Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave (vlerës së tregut).

Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”

Përcaktimi i bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtësë, ndjek këtë radhë vlerësimi:

1. Vetëdeklarimi (*Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtësë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim.*)
2. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP).
3. Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/ njësi pronësore (*Kur vlerësimi sipas pikave 1 dhe 2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtësë/ njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve*)
4. Gajtë verifikimit në terren nëse nuk sigurohet informacion lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/ njësisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren, si më poshtë:
 - Sipërfaqja e prezumuar nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/ njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqen e verifikuar në terren, si më poshtë:
 - 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.
 - 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.

Këshilli Bashkiak redukton çmimin mesatar referues të përcaktuar në Aneksin 1, të VKM nr.132 datë 07.03.2018, në masën 30% për banesat për qëllime banimi në Njësitë Adiministrative që ju bashkëngjiten qëndrave më të afërta.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve janë:

- a. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “biznes”, “familjare” strukturë përgjegjëse është drejtoria e taksave dhe tarifave vendore, e cila kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqeve dhe vlerës së taksës dhe kategorive sipas tabelës së cituar më lart. Detyrimi është vjetor.



Në rastet e mungesës ose mosparaqitjes së dokumentacionit për pronësinë mbi ndërtesa:

- a. Kategoria familjare, kanë për detyrë të paraqesin pranë drejtorisë taksave dhe tarifave çertifikatën e pronësisë banesës mbi bazën e të cilit bëhet faturimi për taksën mbi ndërtesën. Në rast të mosparaqitjes të dokumentacionit të sipërcituar, atëherë do të faturohet për një sipërfaqe banese prej 100 m² për cdo kryefamiljar.
- b. Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës mbi ndërtesat do t'i referohen VKM nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës ". Në rastet e konstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së ndërtesës në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do të zbatohen procedurat e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, neni 116.

Përfshihen nga taksat mbi ndërtesat (sipas VKM nr. 132):

- Pronat e shtetit dhe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM, në administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara.
- Banesat sociale në pronësi të bashkive
- Pasuritë e paluajtshme, pronë e subjekteve juridike ose fizike që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren për banesa sociale.
- Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre
- Strukturat akomoduese "Hotel/resort me katër yje, status sociale sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name"
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, kur familjet e tyre përbëhen vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paafte për punë.
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohëshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose të trashëgimisë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Për të përfituar këto lehtësira fiskale kategoria familjare, duhet të depozitohet pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore:



- a. Certifikatën familjare
- b. Vertëtimin nga bashkia për përfituesit e Ndhmës ekonomike

2/2. Taksa mbi tokën bujqësore

Baza ligjore: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 “Taksa mbi token bujqësore”, i ndryshuar me Ligjin nr.142 datë 17.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632/2006”, Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/a. Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 6, ANEKSI I.

Përkufizimi: “*Tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurive.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. (*Dokumentet e pronësisë, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës*). Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore janë të ardhura që derdhen 100% për llogari të buxhetit të Bashkisë.

Niveli i taksës së tokës bujqësore: Niveli i taksës mbi pasuritë e paluajtshme - tokë bujqësore caktohet në lekë për hektar. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Tabela 4: Niveli i taksës për pasurinë e paluajtshme - tokë bujqësore sipas kategorive

| Nr. | Kategoritë e tokës | Njësia | Niveli i taksës |
|-----|--------------------|------------------------|-----------------|
| 1 | Klasa I | | 980 |
| 2 | Klasa II | | 840 |
| 3 | Klasa III | Lekë/ha/m ² | 770 |
| 4 | Klasa IV | | 700 |
| 5 | Klasa V | | 630 |
| 6 | Klasa VI | | 560 |
| 7 | Klasa VII | | 490 |

Për taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore, jepet lehtësim ose përjashtim i përkohshëm. Kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar, deri në vlerën 75 % (shtatëshjetë e pesë) përqind.



Përfshihen nga taksa bujqësore:

- Sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **5 (pesë)** vitet e para.
- Toka bujqësore e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore në masën **75 % (shtatëdhjetë e pesë) përqind** e vlerës së taksës për sipërfaqen e dëmtuar.

Ngarkohet sektori i regjistrimit dhe të gjitha pronave të saktësojë aktin e marrjes në pronësi sipas personave duke pasqyruar ndryshimet e herë pas herëshme duke ia përcjell drejtorisë së taksave.

2/3. Taksa Mbi Truallin

Baza ligjore: Ligji 142/2015, date 21.12.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9632, 30.12.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 23/1,; Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 11 pika 2/a; Ligji nr.95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, dt.30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 7, ANEKSI 2.

Përkufizim: Truall është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Baza e taksës mbi truallin është *sipërfaqja e truallit në metër katror*, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës mbi truallin: Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Për çdo kategori minimale të truallit, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Sipas kategorizimeve të bashkive, të bëra me ligj, taksa mbi truallin është në masën:

| | Përshkrimi | Njësia | Propozohet |
|---|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|
| 1 | Për qëllime banimi nga individët | lekë/m²/vit | 0.12 lekë/m²/vit |
| 2 | Për qëllime biznesi, | lekë/m²/vit | 12 lekë/m²/vit |

Detyrimi për pagesë të taksës: Detyrimi për pagesën e taksës mbi truallin është vjetor. Detyrimi i taksës llogaritet në bazë të sipërfaqës dhe vlerës së taksës.

Detyrimi për taksën e truallit për bizneset do të llogaritet në bazë të sipërfaqës së ndërtesës së aktivitetit, deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetëdeklarimit të sipërfaqës së truallit.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin është Sektori i të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore pranë Bashkisë Mirditë si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.



Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe sektori i Menaxhimit të Aseteve të pasqyrojë ndryshimet e herë pas herëshme dhe ti dërgoje për llogartje detyrimi pranë drejtorisë taksave dhe tarifave vendore.

3.TAKSA VENDORE MBI VEPRIMTARINË E SHËRBIMIT HOTELIER.

Baza ligjore: Ligji nr. 142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, neni 26, ANEKSI 8.

Përkufizimi: Me "Hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe këto struktura akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: Hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës: Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Tabela 7: Niveli taksës së fjetjes në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë apo në juridikson të së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës **5 (pesë) të muajit pasardhës**.

| Nr. | KATEGORITË | Njësia | Niveli i taksës |
|-----|--|-----------------------------|-----------------|
| 1 | Hotel 4, 5 yje | Lekë/nate qëndrimi në hotel | 122.5 lekë |
| 2 | Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin. | | 49 lekë |

Pagesa kryhet brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

- Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë përcaktohet sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar).
- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet.



- Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës është si vijon:

- a. **Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi nga shoqëritë e ndërtimit** të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa ndikimit në infrastrukturë është në masën **3 % (tre përqind)** të cmimit të shitjes për m². Çmimi i shitjes për m² (metër katror) bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Per miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.
- b. **Në rastin e ndërtimeve për qëllime shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit**, (me destinacion tregtimi) të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa ndikimit në infrastrukturë është në masën **4 % (katër përqind)** të cmimit të shitjes për m² katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Per miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.
- c. **Në rastin e ndërtimeve për qëllime shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit**, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa ndikimit në infrastrukturë është në masën **5 % (pesë përqind)** të cmimit të shitjes për m² katror. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave" që miratohet çdo vit.
- d. **Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2**, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe për bashkinë Mirditë është deri në **3 % (tre përqind)** e saj, dhe konkretisht:
 - ✓ Ndërtime me funksion prodhim, përpunim dhe ruajtje produktesh bujqësore dhe blegtorale, (stalla, komplekse, depo etj. të ngjashme) **1 % (një përqind)** e vlerës të investimit.
 - ✓ Ndërtime me funksione për industrinë prodhuese dhe përpunuese etj. të ngjashme **3 % (një përqind)** e vlerës të investimit.
 - ✓ Ndërtimi me funksion për industrinë prodhuese dhe përpunuese produktesh bujqësore dhe blegtori.
 - ✓ Objekte me përdorim në sektorin e turizmit **1 % (një përqind)**.
- e. **Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte**, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është **0.1 % (zero pik një përqind)** e vlerës së investimit, por jo me pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
- f. **Për ndërtesat të cilat janë në proces legalizimi**, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është **0.5 % (zero pikë pesë përqind)** e vlerës së investimit. Detyrimi për pagesën e taksës i



takon investitorit. E ardhura nga taksa, për cdo rast mblihet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për cdo rast, për llogari të bashkisë që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

- g. **Për punime që kryhen në zbatim të VKM. nr. 408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"** (i ndryshuar), neni 6, ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, me **Autorizimin Punimesh**, tarifa e pajisjes është **2 000 lekë**.
- h. Për punime që kryhen në zbatim të VKM. nr. 408, datë 13.5.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" (i ndryshuar), neni 7, punime që kryhen me **Deklaratë Paraprake Punimesh**, tarifa e aplikimit është **5 000 lekë**.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura e kësaj takse për cdo rast, mblihet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet për cdo rast për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Përfshihen nga pagesa e kësaj takse:

- ✓ Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me 5 (pesë) yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombtarisht brand name" (i ndryshuar me ligjin 142/2015).
- ✓ Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- ✓ Përfshihen të gjitha ndërtimet pritëse që do të kryhen për eliminimin e pasojave të tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 si dhe ndërtimet që kryhen nga OJF dhe Shoqata humanitare për familjet në nevojë

Mënyra e pagesës:

- ✓ Taksa paguhet brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** nga data e njoftimit për vlerësimin pozitiv të vendimit për miratimin lejes për punime dhe lëshimit të autorizimit të pagesës nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në bashki. Në rast se kërkuesi nuk kryen pagesën brenda **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** punë, nga njoftimi për detyrimin ndaj shtetit, sipas ligjit, atëherë për çdo vonesë i llogaritet kamata **0.2 % (zero pikë dy) përqind në ditë** e shumës që duhet të paguajë, deri në **30 (tridhjetë) ditë pune**. Nëse në përfundim të këtij afati, kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, kryetari i bashkisë vendos masa të tjera të përshtatshme deri revokimin e lejes.
- ✓ Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashki dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mos shlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të pajisjes me certifikatë përdorimi të subjektit.



Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e bashkisë Mirditë. Me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë i jepet subjektit leja për fillimin e punimeve.

Drejtoria Urbanistikës dhe zhvillimit urban, përcjell informacionin tek Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore që bën vjeljen e taksës. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit për objektet e reja pranë Bashkisë Mirditë, vetëm pasi të konfirmohet pagesa taksës e ndikimit në infrastrukturë nga Drejtoria e të ardhurave të Bashkisë Mirditë.

5.KONTRIBUTI I SEKTORIT PRIVAT NË KRIJIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE.

1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimipër ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 m², siguron kalimin pa shpërblim të te një apartamenti me sip 80-90 m² me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqetjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendor dhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Kushte lehtësuese:Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për efijencën e energjisë urbane, projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri, atëherë subjektit i rimburohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

Përjashtime:

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje,status special",sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.



Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Përjashtohen sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Drejtoria përgjegjëse për të ardhurat.

Të gjithë investitorët (individë, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj) do të pajisen me lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Mirditë, vetëm pasi:

- të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe detyrimet përkatëse për tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit;
- për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2,000 m², përveç shlyerjes së detyrimeve të mësipërme, duhet edhe të kenë nënshkruar kontratën me Bashkinë Mirditë për fondin e banesave sociale.

Të gjithë individët, persona fizik, OJF, subjektet ndërtuese, etj, do të pajisen me deklaratën paraprake të punimeve pranë Bashkisë Mirditë, vetëm pasi të kenë paguar tarifën e pastrimit për kantierin e ndërtimit.

6. TAKSA E TABELËS

Baza ligjore: Ligji nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar, neni 8, Aneksi 7 "Taksa e tabelës sipas kategorive të bashkive"

Ligji nr.95/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, dt.30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, neni 10.

Baza e taksës: Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Mbështetur në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, dhe ligjin 142/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632 dt 30.10.2006, ligji 106/2017 datë 30.11.2017 aneksi 7.

Taksa e tabelës aplikohet për të gjithë subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe profesioneve të lira.



Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Llojet e tabelave | Nj/matëse lekë m ² /vit | Bashkia Mirditë |
|----------|---|---------------------------------------|--------------------|
| 1 | Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve (ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit) | | |
| a | deri në 2 m² | Lekë / m ² / vit | 0 |
| b | Mbi 2 m² deri në 10 m² | | |
